VENDIM
Nr.342, datë 20.5.2005

MBI ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR PRIVAT "RADIO 7"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", vendimeve të KKRT-së, nr.54, datë 16.7.2001 dhe nr.253, datë 31.8.2004, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë" të miratuar me vendimn nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit "Media J-7" sh.p.k. për radion vendore private "Radio 7", me nr.licence 032/FML, në prefekturën e Fierit.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.

3. Ngarkohet Departamenti Teknik, Departamenti Ekonomik dhe Departamenti Juridik dhe i licencave për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj